




**BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SHA
DEGA NË KOSOVË**

Nr. _____ Prot. _____



Prishtinë, më 14.11.2025

Lënda: Në vijim të shkresës tonë me Nr. 237 Prot., datë 23.10.2020 - Ridërgimi i Kërkesë për përcaktimin e Tarifave të NEMO për vitin 2026, 2027, 2028.

ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Rruga: Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, Prishtinë 10000, Kosovë

I nderuar Z. Fejzullahu,

Në vijim të shkresës tonë me Nr. 237 Prot., datë 23.10.2025 dërguar pranë ZRrE, me lëndën "Kërkesë për përcaktimin e Tarifave të NEMO për vitin 2026, 2027, 2028, ju informojmë që në vijim të miratimit të Programit Ekonomik për vitin 2026 pranë organeve drejtuese të Shoqërisë së bashku me parashikimet për vitet 2027 dhe 2028, u rishikuan të dhënat e tregut, trendi i volumeve në Bursë së bashku me numrin e Anëtarësimeve gjë e cila çoi në rishikimin e të dhënave dhe reflektimin e tyre tek të ardhurat e parashikuara më parë dhe dërguar tek ju më dt.23.10.2025. Pas rregullimeve të nevojshme paraqesim pranë jush dokumentin e rishikuar.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni:

- Relacioni e rishikuar për përcaktimin e tarifave

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

Drejtor Menaxhues i ALPEX sh.a.-Dega në Kosovë

Sokol Dishnica

Për:

RELACION

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË NEMO PËR VITET 2026, 2027, 2028

Përmbajtja

I.	Informacion i përgjithshëm rreth shoqërisë.....	3
II.	Baza ligjore për përcaktimin e tarifave	5
III.	Transaksionet e energjisë	5
IV.	Realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2020-2024, pritshmëritë për vitin 2025 dhe parashikimi për tre vite	9
V.	Anëtarësimi në ALPEX	9
VI.	Llogaritja e tarifave të NEMO-s.....	10
A.	Baza e Rregulluar e Aseteve.....	10
B.	Kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes.....	12
C.	Kostot e lejuara të amortizimit të vitit.....	12
D.	Norma e Lejuar e Kapitalit të Punës.....	13
E.	Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës.....	13
F.	Të ardhurat jo tarifore.....	13
VII.	Të ardhurat e parashikuara nga Tarifat	13
VIII.	Metodologjia për llogaritjen e Tarifave të NEMO.....	14

I. Informacion i përgjithshëm rreth shoqërisë

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SHA (në vijim ALPEX), është Operatori i Tregut i parashikuar në ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe VKM Nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” i ndryshuar, si struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nëpërmjet platformës elektronike të tregtimit, platformës elektronike të klerimit dhe të shlyerjes financiare për tregjet e ankandëve të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe tregjeve të vazhdueshme brenda së njëjtës ditë, ndërmjet Anëtarëve të Bursës, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe aktivitetin e kompensimit financiar (clearing) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut.

ALPEX është krijuar në përputhje me VKM-në Nr.322 datë 15.05.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut”, VKM-në Nr.609 datë 11.09.2019 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut”.

ALPEX u krijua nga dy aksionarët, Operatorit të Sistemit të Transmetimit - OST SHA dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës - KOSTT SHA. Me kërkesë të këtij të fundit dhe vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, KOSTT SHA i ka deleguar ALPEX të drejtën për të organizuar dhe menaxhuar tregjet e organizuara të energjisë elektrike për Zonën e Ofertimit të Kosovës.

Enti Rregullator i Shqipërisë sipas Vendimit të Bordit Nr. 247, datë 29.09.2022 e licensoi ALPEX si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike dhe me Vendim të Bordit Nr. 228, datë 17.07.2023 emëroi ALPEX si Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë. Me Vendimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji ZRrE V_1748_2023, ALPEX-i u përcaktua si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për Zonën e Ofertimit të Kosovës.

Me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 347, datë 27.12.2022 “Për Miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)”, të ndryshuara me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 106, datë 23.03.2023, si edhe me Vendimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji ZRrE V_1638_2022, të ndryshuara me Vendimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji ZRrE V_2586_2024 të përbëra nga katër dokumente:

- a. Rregullat e ALPEX- Kushtet e Përgjithshme
- b. Rregullat e ALPEX-Procedura e Tregtimit
- c. Rregullat e ALPEX- Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes
- d. Rregullat e ALPEX-Përkufizimet

ALPEX ka implementuar Tregun e Ditës në Avancë në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë prej datës 11.04.2023 dhe për Zonën e Ofertimit të Kosovës prej datës 31.01.2024 e cila shënoi dhe fillimin e

bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë midis Shqipërisë dhe Kosovës. Ky Bashkim Tregjesh është implemetuar sipas modelit të SDAC që lidhet me afatet kohore të hapjes dhe mbylljes së portës, Çmimit minimal dhe maksimal Klerues, Çmimit minimal dhe maksimal të Urdhërporosive. Operimi i Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë kryhet bazuar mbi Marrëveshjen Operacionale të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë dhe mbi procedurat të cilat janë:

- a) Procedurat normale (DAC_NOR_XX)
- b) Procedura Rezervë (DAC_BUP_XX)
- c) Procedura Alternative (Fallback) (DAC_FAL_XX)
- d) Procedurat e Veçanta (DAC_SPE_XX)
- e) Procedurat e tjera (DAC_OTH_XX)

ALPEX ka implementuar Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe të Kosovës prej datës 11.12.2024 e cila shënoi dhe fillimin e bashkimit të Tregjeve e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë midis Shqipërisë dhe Kosovës. Ky Bashkim Tregjesh është implemetuar sipas modelit të SIDC që lidhet me afatet kohore të hapjes dhe mbylljes së portës, Çmimit minimal dhe maksimal Klerues, Çmimit minimal dhe maksimal të Urdhërporosive. Operimi i Bashkimit të Tregjeve të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë kryhet bazuar mbi Marrëveshjen Operacionale përkatëse dhe mbi procedurat të cilat janë:

- a) Procedurat normale (IDAC_NOR_XX)
- b) Procedura Rezervë (IDAC_BUP_XX)
- c) Procedura Alternative (Fallback) (IDAC_FAL_XX)
- d) Procedurat e Veçanta (IDAC_SPE_XX)
- e) Procedurat e tjera (IDAC_OTH_XX)

Shqipëria dhe Kosova kanë përcaktuar qartë në aktet nënligjore dhe dokumentet e tjera zyrtare qëllimin për integrimin e tregjeve të tyre me shumicë të energjisë elektrike në tregun e vetëm evropian të ditës në avancë (Single Day-Ahead Coupling - SDAC) dhe atij brenda së njëjtës ditë (Single Intraday Coupling - SIDC). Për këtë qëllim si hapi i parë operatorët e sistemit të transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Kosovës (KOSTT) si dhe ALPEX janë pranuar zyrtarisht vëzhgues në SDAC dhe SIDC. Pas transpozimit të legjislacionit të kërkuar evropian në legjislacionet e tyre kombëtare të tre kompanitë do të mund të bëhen anëtare me të drejta plota në këto tregje. Referuar modelit të SDAC dhe SIDC integrimi i këtyre tregjeve do të kalojë nëpërmjet projekteve në nivel rajonal, që për rastin e Shqipërisë dhe Kosovës kjo kalon nga projekti i quajtur Italian Bidding Working Table (IBWT). ALPEX, OST dhe KOSTT janë pranuar si vëzhgues në këtë projekt duke nënshkruar dhe marrëveshjen përkatëse operacionale.

Qëllimi është që kufijtë energjetik të Shqipërisë dhe Kosovës të integrohen në SDAC nëpërmjet zbatimit të projekteve lokale për kufijtë AL-GR, AL-XK dhe XK-NM dhe në SIDC nëpërmjet projekte lokale të zbatimit në kufijtë AL-GR dhe AL-XK.

II. Baza ligjore për përcaktimin e tarifave

Metodologjia e Përcaktimit të Tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) është miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në fund të vitit 2024 dhe përcakton bazën dhe procesin për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike.

Sipas metodologjisë, të ardhurat e lejuara të NEMO-s, mbulojnë kostot e arsyeshme të aktivitetit të NEMO-s. Këto përfshijnë:

1. Kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes;
2. Kostot e lejuara të amortizimit të vitit;
3. Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit;
4. Norma e Lejuar e Kapitalit të Punës;
5. Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës.

Në kapitujt vijues janë të paraqitur të dhënat e nevojshme për llogaritjen e të Ardhurave të Lejuara për tre vitet e ardhshme si dhe gjitha kostot në përputhje me parimet rregullative duke siguruar që të ardhurat e NEMO-s të jenë transparente dhe të paanshme, bazuar në kritere jodiskriminuese.

III. Transaksionet e energjisë

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të transaksioneve të energjisë të realizuara nga ALPEX për vitin 2024 dhe për 9-mujorin e vitit 2025.

1. Realizimi i Transaksioneve të energjisë për vitin 2024

Transaksionet për shitjen dhe blerjen e energjisë, volumet e shitura dhe blera, për vitin 2024 i paraqesim në tabelat e mëposhtme;

Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX në zonën e ofertimit Shqipëri 2024						
	Blerje		Shitje		Totali Blerje/Shitje	
Periudha	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	74,601.20	7,255,210.28	74,619.20	7,257,541.52	149,220.40	14,512,751.81
Shkurt	79,430.32	5,950,254.94	59,386.37	4,795,170.42	138,816.69	10,745,425.36
Mars	79,647.32	5,612,237.00	60,229.35	4,485,492.84	139,876.66	10,097,729.84
Prill	72,729.89	4,443,105.58	41,431.79	2,598,868.65	114,161.68	7,041,974.22
Maj	76,710.33	5,626,012.38	35,058.50	2,321,504.41	111,768.83	7,947,516.79
Qershor	67,656.09	7,150,579.14	26,615.47	3,180,371.66	94,271.56	10,330,950.80
Korrik	54,980.15	8,245,691.77	42,684.29	6,814,606.14	97,664.44	15,060,297.91
Gusht	51,137.79	6,762,080.18	35,676.01	4,935,522.04	86,813.80	11,697,602.22
Shtator	47,673.48	5,809,903.95	41,657.81	5,252,688.30	89,331.29	11,062,592.25
Tetor	54,862.80	5,490,872.27	43,000.10	4,533,966.59	97,862.90	10,024,838.86
Nentor	61,537.10	10,986,173.09	51,207.79	9,512,964.24	112,744.89	20,499,137.33
Dhjetor DAM	57,168.11	8,672,884.44	53,487.85	8,304,615.98	110,655.96	16,977,500.41
Dhjetor IDM	98.23	11,353.47	102.38	25,714.53	200.61	37,068.00
Total 2024	778,232.81	82,016,358.48	565,156.91	64,019,027.32	1,343,389.72	146,035,385.80

Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në Zonën e Ofertimit të Kosovës

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX në zonën e ofertimit Kosovë 2024						
Periudha	Blerje		Shitje		Totali Blerje/Shitje	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	417.00	48,033.80	399.00	45,702.56	816.00	93,736.36
Shkurt	9,060.83	706,862.50	29,104.78	1,861,947.01	38,165.61	2,568,809.51
Mars	49,118.40	3,371,495.94	68,536.37	4,498,240.09	117,654.78	7,869,736.03
Prill	51,230.96	3,215,597.63	82,529.06	5,059,834.56	133,760.03	8,275,432.19
Maj	55,908.42	4,118,038.50	97,560.25	7,422,546.47	153,468.67	11,540,584.97
Qershor	36,284.89	3,778,094.79	77,325.51	7,747,201.18	113,610.40	11,525,295.97
Korrik	29,309.44	4,917,082.78	41,605.30	6,348,168.41	70,914.74	11,265,251.20
Gusht	27,155.41	3,935,092.75	42,617.19	5,761,290.99	69,772.60	9,696,383.75
Shtator	30,542.77	3,733,094.94	36,558.44	4,290,310.59	67,101.21	8,023,405.53
Tetor	32,126.48	3,348,741.11	43,989.18	4,305,646.78	76,115.66	7,654,387.89
Nentor	32,279.61	5,863,432.99	42,608.92	7,336,641.84	74,888.53	13,200,074.83
Dhjetor DAM	41,718.34	6,241,282.98	45,398.60	6,609,551.44	87,116.94	12,850,834.42
Dhjetor IDM	91.15	22,905.06	87.00	8,544.00	178.15	31,449.06
Total 2024	395,243.70	43,299,755.77	608,319.61	61,295,625.93	1,003,563.30	104,595,381.70

Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në Bashkimin e Tregjeve Shqipëri-Kosovë

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX për dy Zonat e Ofertimit 2024				
Periudha	Blerje		Shitje	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	75,018.20	7,303,244.08	75,018.20	7,303,244.08
Shkurt	88,491.15	6,657,117.44	88,491.15	6,657,117.44
Mars	128,765.72	8,983,732.93	128,765.72	8,983,732.93
Prill	123,960.85	7,658,703.21	123,960.85	7,658,703.21
Maj	132,618.75	9,744,050.88	132,618.75	9,744,050.88
Qershor	103,940.98	10,928,673.93	103,940.98	10,927,572.83
Korrik	84,289.59	13,162,774.55	84,289.59	13,162,774.55
Gusht	78,293.20	10,697,172.93	78,293.20	10,696,813.03
Shtator	78,216.25	9,542,998.89	78,216.25	9,542,998.89
Tetor	86,989.28	8,839,613.37	86,989.28	8,839,613.37
Nentor	93,816.71	16,849,606.08	93,816.71	16,849,606.08
Dhjetor DAM	98,886.45	14,914,167.42	98,886.45	14,914,167.42
Dhjetor IDM	189.38	34,258.53	189.38	34,258.53
Total 2024	1,173,476.51	125,316,114.25	1,173,476.51	125,314,653.25

Gjatë vitit 2024 ka pasur vetëm dy herë ndryshime të çmimit klerues midis dy zonave të ofertimit të Shqipërisë dhe të Kosovës, në një vlerë totale 1,461.00 Euro.

Transaksionet Ndërkufitare për vitin 2024 i paraqesim në tabelat e mëposhtme;

Tabela me transaksionet ndërkufitare me lëvizje nga Shqipëria në Kosovë:

Transaksionet ndërkufitare AL-XK për vitin 2024				
Periudha	Eksport		Import	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	-	-	-	-
Shkurt	1,439.00	118,741.51	20,391.50	1,200,612.10
Mars	1,753.37	149,907.75	21,240.90	1,328,087.39
Prill	1,011.91	66,421.79	32,801.17	1,901,046.58
Maj	983.82	91,858.22	41,825.99	3,279,131.18
Qershor	381.21	51,508.69	41,859.80	4,015,928.24
Korrik	4,351.68	657,951.23	17,340.78	2,161,669.25
Gusht	4,569.95	583,538.48	19,640.08	2,374,393.79
Shtator	4,496.17	545,055.06	10,975.14	1,154,329.43
Tetor	1,742.54	206,360.17	12,735.94	1,083,084.20
Nentor	2,688.34	506,735.35	13,960.00	2,087,945.73
Dhjetor	4,490.10	805,465.10	8,412.73	1,162,223.74
Total	27,908.09	3,783,543.35	241,184.03	21,748,451.63

Tabela me transaksionet ndërkufitare me lëvizje nga Kosova në Shqipëri:

Transaksionet ndërkufitare XK-AL për vitin 2024				
Periudha	Eksport		Import	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	-	-	-	-
Shkurt	20,391.50	1,200,612.10	1,439.00	118,741.51
Mars	21,240.90	1,328,087.39	1,753.37	149,907.75
Prill	32,801.17	1,901,046.58	1,011.91	66,421.79
Maj	41,825.99	3,279,131.18	983.82	91,858.22
Qershor	41,859.80	4,015,928.24	381.21	51,508.69
Korrik	17,340.78	2,161,669.25	4,351.68	657,951.23
Gusht	19,640.08	2,374,393.79	4,569.95	583,538.48
Shtator	10,975.14	1,154,329.43	4,496.17	545,055.06
Tetor	12,735.94	1,083,084.20	1,742.54	206,360.17
Nentor	13,960.00	2,087,945.73	2,688.34	506,735.35
Dhjetor	8,412.73	1,162,223.74	4,490.10	805,465.10
Total	241,184.03	21,748,451.63	27,908.09	3,783,543.35

2. Realizimi i Transaksioneve të energjisë për 9-mujorin e vitit 2025

Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë për 9-mujorin e vitit 2025

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX në zonën e ofertimit Shqipëri 2025						
Periudha	Blerje		Shitje		Totali Blerje/Shitje	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	49,558.97	7,150,933.34	57,822.83	8,723,738.60	107,381.80	15,874,671.94
Shkurt	40,932.58	6,558,504.31	54,095.51	8,663,856.27	95,028.09	15,222,360.58
Mars	52,817.21	5,109,135.19	51,269.25	5,133,224.06	104,086.46	10,242,359.25
Prill	63,404.18	4,755,445.80	66,523.02	5,264,049.99	129,927.20	10,019,495.79
Maj	65,250.72	5,106,789.31	63,728.35	4,944,401.04	128,979.07	10,051,190.35
Qershor	60,414.23	5,978,847.27	68,812.11	7,479,543.85	129,226.34	13,458,391.12
Korrik	86,598.45	10,453,279.27	82,336.75	10,317,283.80	168,935.20	20,770,563.07
Gusht	99,042.99	10,489,709.57	81,026.01	9,317,451.73	180,069.00	19,807,161.30
Shtator	79,402.89	7,913,171.43	65,428.35	6,429,206.05	144,831.24	14,342,377.49
Total 2025	597,422.22	63,515,815.49	591,042.18	66,272,755.40	1,188,464.40	129,788,570.89

Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në Zonën e Ofertimit të Kosovës për 9-mujorin e vitit 2025

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX në zonën e ofertimit Kosovë 2025						
Periudha	Blerje		Shitje		Totali Blerje/Shitje	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	52,304.23	7,788,046.36	44,040.37	6,215,241.10	96,344.60	14,003,287.46
Shkurt	41,905.46	6,809,833.17	28,742.53	4,704,481.21	70,647.99	11,514,314.39
Mars	43,283.33	4,638,448.02	44,831.29	4,614,359.15	88,114.62	9,252,807.16
Prill	67,798.03	6,163,578.17	64,679.19	5,654,973.98	132,477.22	11,818,552.16
Maj	58,924.62	5,569,648.20	60,446.99	5,732,036.46	119,371.61	11,301,684.66
Qershor	80,087.79	9,062,558.08	71,689.91	7,561,861.51	151,777.70	16,624,419.59
Korrik	87,988.20	11,009,990.51	92,249.90	11,115,117.34	180,238.10	22,125,107.85
Gusht	75,477.06	9,169,406.14	93,494.04	10,299,630.76	168,971.10	19,469,036.90
Shtator	49,893.70	5,364,223.56	63,868.17	6,848,176.05	113,761.87	12,212,399.61
Total 2025	557,662.42	65,575,732.21	564,042.39	62,745,877.56	1,121,704.81	128,321,609.77

Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në Bashkimin e Tregjeve Shqipëri-Kosovë për 9-mujorin e vitit 2025

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX për dy Zonat e Ofertimit 2025				
Periudha	Blerje		Shitje	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	101,863.20	14,938,979.70	101,863.20	14,938,979.70
Shkurt	82,838.04	13,368,337.49	82,838.04	13,368,337.49
Mars	96,100.54	9,747,583.21	96,100.54	9,747,583.21
Prill	131,202.21	10,919,023.97	131,202.21	10,919,023.97
Maj	124,175.34	10,676,437.51	124,175.34	10,676,437.51
Qershor	140,502.02	15,041,405.36	140,502.02	15,041,405.36
Korrik	174,586.65	21,463,269.78	174,586.65	21,432,401.14
Gusht	174,520.05	19,659,115.71	174,520.05	19,617,082.50
Shtator	129,296.59	13,277,394.99	129,296.52	13,277,382.10
Total 2025	1,155,084.64	129,091,547.71	1,155,084.57	129,018,632.96

Gjatë 9-mujorit të vitit 2025 ka pasur ndryshime të çmimit klerues midis dy zonave të ofertimit të Shqipërisë dhe të Kosovës gjatë muajit Korrik dhe Gusht, në një vlerë totale 72,914.75 Euro.

Transaksionet Ndërkufitare për 9-mujorin e vitit 2025 i paraqesim në tabelat e mëposhtme;

Tabela me transaksionet ndërkufitare me lëvizje nga Shqipëria në Kosovë:

Transaksionet ndërkufitare AL-XK viti 2025				
Periudha	Eksport		Import	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	11,773.42	1,991,087.10	3,509.56	418,281.84
Shkurt	14,437.68	2,277,260.31	1,274.75	171,908.35
Mars	5,584.44	665,731.30	7,132.40	641,642.70
Prill	8,506.69	942,088.51	5,387.85	433,484.32
Maj	7,333.50	649,636.39	8,855.87	812,024.65
Qershor	22,654.06	2,771,299.59	14,256.18	1,270,603.01
Korrik	18,920.26	2,536,816.69	23,181.96	2,672,812.16
Gusht	11,838.06	1,816,349.54	29,855.04	2,988,607.38
Shtator	10,790.24	1,079,243.25	24,764.73	2,563,198.39
Total	111,838.35	14,729,512.68	118,218.34	11,972,562.81

Tabela me transaksionet ndërkufitare me lëvizje nga Kosova në Shqipëri:

Transaksionet ndërkufitare XK-AL viti 2025				
Periudha	Eksport		Import	
	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	3,509.56	418,281.84	11,773.42	1,991,087.10
Shkurt	1,274.75	171,908.35	14,437.68	2,277,260.31
Mars	7,132.40	641,642.70	5,584.44	665,731.30
Prill	5,387.85	433,484.32	8,506.69	942,088.51
Maj	8,855.87	812,024.65	7,333.50	649,636.39
Qershor	14,256.18	1,270,603.01	22,654.06	2,771,299.59
Korrik	23,181.96	2,672,812.16	18,920.26	2,536,816.69
Gusht	29,855.04	2,988,607.38	11,838.06	1,816,349.54
Shtator	24,764.73	2,563,198.39	10,790.24	1,079,243.25
Total	118,218.34	11,972,562.81	111,838.35	14,729,512.68

IV. Realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2020-2024, pritshmëritë për vitin 2025 dhe parashikimi për tre vite

Ky kapitull paraqet realizimet historike të të ardhurave dhe shpenzimeve të ALPEX për periudhën 2020–2024, pritshmëritë për vitin 2025 dhe parashikimin për vitet 2026, 2027, 2028.

Tabela e mëposhtme paraqet situatën financiare për të dy zonat e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës, sipas Bilancit për vitet 2020-2024, pritshmëritë për vitin 2025, dhe parashikimin për tre vitet e ardhshme.

	Realizim 2020	Realizim 2021	Realizim 2022	Realizim 2023	Realizim 2024	Realizimi i pritshëm për vitin 2025	Parashikim për vitin 2026	Parashikim për vitin 2027	Parashikim për vitin 2028
	258	1,780	0	465,470	656,701	1,236,207	1,558,591	1,683,712	1,992,389
	258	1,780	0	433,891	392,494	719,126	889,563	971,302	1,156,776
	0	0	0	31,580	264,207	517,081	669,028	712,410	835,613
	16,021	312,032	520,168	1,227,641	1,031,933	1,562,169	2,153,590	2,203,029	2,041,321
	16,021	276,653	420,944	901,390	784,094	1,107,324	1,514,223	1,563,452	1,492,629
	0	35,379	99,223	326,251	247,839	454,846	639,367	639,576	548,692
	-15,763	-310,252	-520,168	-762,170	-375,231	-325,963	-595,000	-519,317	-48,932
rate	-6114.57%	-17426.40%	#DIV/0!	-163.74%	-57.14%	-26.37%	-38.18%	-30.84%	-2.46%

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme në tre vitet e para të krijimit shoqëria nuk ka realizuar të ardhura për arsye që aktivitetin e ka nisur në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2023 për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe në tremujorin e parë të vitit 2024 edhe për zonën e ofertimit të Kosovës. Duke analizuar realizimet në vitin 2024 me pritshmërinë për vitin 2025 vihet re një përmirësim i situatës duke ulur % midis Humbjes dhe të Ardhurave. Gjithashtu edhe sipas parashikimeve në tre vitet në vijim situata do të përmirësohet çdo vit, sipas parashikimit që do të kemi të njëjtat tarifa edhe për tre vitet në vijim.

V. Anëtarësimi në ALPEX

Ky kapitull paraqet përbërjen aktuale të Anëtarëve të Bursës Shqiptare të Energjië Elektrike deri në Shtator 2025. Deri në këtë periudhë, janë të anëtarësuar rreth 42 Anëtarë të Bursës dhe 5 Anëtar të Përgjithshëm Klerimi, si në vijim:

- Gjithsej për zonën e ofertimit të Shqipërisë janë:
 - 26 Anëtarë Burse nga të cilët 5 janë shoqëri publike dhe 21 janë shoqëri private.
 - 1 Anëtarë Burse është në proces anëtarësimi.
 - 2 Anëtar të Përgjithshëm Klerimi, Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank.
- Gjithsej për zonën e ofertimit të Kosovës janë:
 - 16 Anëtarë Burse nga të cilët 3 janë shoqëri publike dhe 13 janë shoqëri private.
 - 1 Anëtarë Burse është në proces anëtarësimi.
 - 3 Anëtar të Përgjithshëm Klerimi, Procredit Bank, Banka Kombëtare Tregtare dhe Raiffeisen Bank në Kosovë.

VI. Llogaritja e tarifave të NEMO-s

Tarifat e ALPEX synojnë të mbledhin të ardhurat e nevojshme për të kryer investime të dobishme të NEMO-së që janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të saj si edhe për të mbuluar kostot të operimit dhe mirëmbajtjes të shoqërisë (të çdo njësie ekonomike mëmë ose çdo njësie ekonomike të lidhur) që mund t'i atribuohet në mënyrë të arsyeshme NEMO-s.

Niveli i lejuar i të ardhurave që kërkohet nga ALPEX do të mbulojë të gjitha kostot e lejuara nga Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), që janë kryesisht kostot operative.

Të ardhurat e Lejuara të NEMO-s do të llogariten sipas formulës:

$$NEMORR = (RAB * WACC) + (OPMC + DEPC + WCLC + LICC - NTFR)$$

A. Baza e Rregulluar e Aseteve

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) për NEMO përcaktohet me qëllim llogaritjen e Amortizimit të Lejuar dhe Normës së lejuar të kthimit të kapitalit. Të dy këta komponentë përbëjnë pjesë të kostove të lejuara që përdoren për të përcaktuar nivelin e të ardhurave të lejuara, të cilat NEMO mund t'i rikuperojë përmes tarifave.

Edhe pse metodologjia parashikon ekzistencën e një Plani të Lejuar të Investimeve, në rastin e ALPEX-it investimet kryesore lidhen kryesisht me pajisjet e Teknologjisë së Informacionit (IT) dhe pajisjet e zyrës. Për shkak të natyrës së këtyre investimeve, nuk ka një plan formal investimesh kapitale. Të gjitha investimet operative që realizohen gjatë periudhës rregullore mund të përfshihen në Bazën e Rregulluar të Aseteve gjatë rishikimeve tarifore sipas metodologjisë.

Formula ***RAB*WACC*** sipas së cilës;

RAB - Baza e Rregulluar e Aseteve

WACC - Norma e Kosos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit

Sipas metodologjisë ***RAB*** llogaritet sipas formulës:

$$RAB = A - DEPC - AD - CG + WC + INV$$

Ku:

A - Vlera e njohur e aktiveve të dobishëm dhe në përdorim/operim në fillim të periudhës rregullore

DEPC - Kostot e lejuara të amortizimit (të akumuluar)

AD - Asset disposal / Retirement of assets

CG - asetet e financuara nga grantet

WC - Shpenzimet kapitale

INV - investime kur asetë është futur në shërbim dhe me koston e lejuar në planin e lejuar të investimeve

Llogaritja e Asetit Bazë të Rregulluar (**RAB**) në fillim të vitit bazë 2026 (Vlera në fund të vitit 2025) është kryer duke llogaritur kapitalizimin e të gjitha investimeve në proces deri në 30.09.2025. Në llogaritjen e amortizimit të vitit 2025, është mbajtur parasysh fakti që shtesat e vitit 2025 kontabilizohen përgjatë gjithë vitit dhe janë amortizuar për mesatarisht 2 muaj duke marrë në konsideratë kohën në të cilën kapitalizohen.

Për vitin 2026 është llogaritur;

A - Asetet në fillim të vitit 2026 janë rreth 207,754 Euro

DEPC - Amortizimi pritët të jetë rreth 135,490 Euro

AD / CG / WC - janë 0 Euro

INV - janë 6,600 Euro

Parashikim Viti 2026										
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	A - Vlera e njohur e aktiveve të dobishëm dhe në përdorim/operim në fillim të periudhës rregulatore	Amortizimi vjetor	D - Kostot e lejuara të amortizimit (të akumuluar)	Vlera neto e aseteve	AD - Asset disposal / Retirement of assets	CG - asetet e financuara nga grantet	WC - Shpenzimet kapitale	INV-investime kur asetë është futur në shërbim dhe me koston e lejuar në planin e lejuar të investimeve
1	2	3	4	5	6-15	7	8	9	10	
1	Mjete transporti	215	29,940	2,994.00	22,643	7,297	-	-	-	-
2	Pajisje informative	218	118,523	21,900.23	71,527	46,996	-	-	-	-
3	Mobilje dhe pajisje zyre	218	37,487	4,494.25	25,664	11,822	-	-	-	-
4	Mobilje dhe pajisje zyre KS	218	9,121	1,533.16	5,841	3,280	-	-	-	3,000
5	Pajisje informative KS	218	12,684	2,187.59	9,815	2,869	-	-	-	3,600
6							-	-	-	-
	Total		207,754	33,108	135,490	72,264	0	0	0	6,600

Sipas metodologjisë **WACC** - Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit llogaritet sipas formulës:

$$WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1$$

Ku:

ES Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB

T Norma e taksës së korporatës (Tatim-fitimi)

ARoE Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse

DS Objektivi për raportin e borxhit në RAB

CoD Kosto e borxhit

ARoE - Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazën e nevojës së ALPEX për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe operative duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë.

CoD - Kosto e borxhit – ALPEX aktualisht nuk ka kosto të borxhit .

Për vitin 2026 është llogaritur;

ES - Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB 100%

T - Norma e taksës së korporatës (Tatim-fitimi) 15%

ARoE - vendoset nga ZRRE

DS - Objektivi për raportin e borxhit në RAB 0%

CoD - Kosto e borxhit 0%

Këto llogaritje janë bërë duke konsideruar dy elementët më poshtë;

- Struktura e kapitalit afatgjatë të ALPEX sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2024 përbëhet vetëm nga kapitali i aksionar në vlerën **100%**.
- Për vitin 2026 norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është: $CoD=0\%$

Nga llogaritjet rezulton që për vitin 2026:

RAB = 78,864 Euro

WACC = 3.53%

RAB*WACC = 2,783.44 Euro

Kurse për vitet 2027 dhe 2028 është përlllogaritur dhe paraqitet në tabelën e kapitullit VIII.

B. Kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes

Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes **OPMC** përfshijnë të gjitha shpenzimet për operimin sa më normal të shoqërisë dhe që ALPEX duhet të mbulojë funksionimin e përditshëm të tregjeve dhe të shërbimeve të tij.

Tarifat e ALPEX synojnë të mbulojnë kostot e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Shpenzimet për shërbimet e Platformës të Tregimit dhe Klerimit.
- c) Shpenzime për furnitura dhe shërbime që lidhen kryesisht me komunikim dhe facilitete të Teknologjisë së Informacionit (IT).
- d) Shpenzimet për qerane e zyrave dhe shpenzime të tjera për zyra.
- f) Shpenzime të lidhura me Personelin.
- g) Shpenzimet të tjera të nevojshme për operimin e Tregut të Ditës në Avancë, Tregut Brenda së Njëjtës Ditë dhe Bashkimin e Tregjeve Shqipëri-Kosovë.

Nga llogaritjet rezulton që **OPMC** për vitin 2026 parashikohet të jetë 2,120,388 Euro.

Vlera e parashikuar e këtyre kostove për dy vitet e ardhshme është përlllogaritur dhe paraqitet në tabelën e kapitullit VIII.

C. Kostot e lejuara të amortizimit të vitit

Këtu përfshihen shpenzimet për amortizimin e lejuar i cili është llogaritur mbështetur në sistemin fiskal për llogaritjen e amortizimit.

Amortizimi për vitin 2026 parashikohet të jetë 28,702 Euro.

Vlera e parashikuar e kostove të amortizimit për dy vitet e ardhshme është përlllogaritur dhe paraqitet në tabelën e kapitullit VIII.

D. Norma e Lejuar e Kapitalit të Punës

Sipas metodologjisë WCLC llogaritet sipas formulës:

$$WCLC = 1/12 * (OPMC + LICC)$$

Ku:

Koeficienti i kapitalit të punës: 1/12

OPMC - kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes

LICC - Tarifa dhe Taksat e Licencës

Për vitin 2026 është llogaritur;

Koeficienti i kapitalit të punës: $1/12 = 0.0833333$

OPMC - kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes janë parashikuar = 2,120,388 Euro

LICC - Tarifa dhe Taksat e Licencës janë parashikuar 4500 Euro

Nga llogaritjet rezulton që **WCLC** për vitin 2026 parashikohet të jetë 176,699 Euro.

Vlera e parashikuar e normës së lejuar e kapitalit të punës për dy vitet e ardhshme është përllogaritur dhe paraqitet në tabelën e kapitullit VIII.

E. Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës

Këto janë Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës dhe sipas metodologjisë, Rregullatori do të lejojë OT-në të mbulojë të gjitha shpenzimet e licencimit dhe shpenzimet tatimore.

Nga llogaritjet rezulton që **LICC** për vitin 2026 parashikohet të jetë 4500 Euro.

Vlera e parashikuar për kostot dhe taksat e tarifave të licencës për dy vitet e ardhshme është përllogaritur dhe paraqitet në tabelën e kapitullit VIII.

F. Të ardhurat jo tarifore

Sipas metodologjisë çdo e ardhur tjetër që nuk mbledhet nëpërmjet tarifave të rregulluara, por që lidhet me ofrimin e shërbimeve të ofruara nga NEMO do të zbritet nga të ardhurat e rregulluara të NEMO-s, duke përfshirë çdo ndryshim midis vlerës së aseteve të nxjerra jashtë përdorimit dhe vlerës së tyre rregullatore.

Në vitet në vijim nuk parashikojmë të kemi të ardhura të tilla, bazuar kjo në eksperiencën e deritanishme.

VII. Të ardhurat e parashikuara nga Tarifat

Duke konsideruar volumin e transaksioneve të energjisë të tregtuara gjatë vitit 2024 në të dy zonat e ofertimit, duke marrë parasysh trendin e volumeve të transaksioneve të energjisë të tregtuara e përgjatë 9-mujorit të vitit 2025 në të dy zonat e ofertimit, si dhe duke konsideruar disa ndryshime

që priten gjatë vitit 2026, parashikohet që të ardhurat në vitin 2026 të jenë rreth 1,558,591 Euro, të ndara si në vijim;

- Për zonën e ofertimit të Shqipërisë janë parashikuar 889,563 Euro
- Për zonën e ofertimit të Kosovës janë parashikuar 669,028 Euro

Vlera e parashikuar e të ardhurave për të dy zonat e ofertimit, sipas tarifave ekzistuese është përlllogaritur dhe paraqitet në tabelën e kapitullit VIII.

VIII. Metodologjia për llogaritjen e Tarifave të NEMO

Duke u bazuar në parashikimet e tregueseve ekonomiko-financiar për tre vitet e ardhshme, si dhe duke u mbështetur në Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), ALPEX SHA ka bërë vlerësimet sipas tabelës në vijim.

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të NEMO						
Përshkrimi	Njësia	Pritshmëritë Viti 2025	Programi Ekonomik Viti 2025	Parashikim Viti 2026	Parashikim Viti 2027	Parashikim Viti 2028
NEMORR = (RAB+WACC)+(OPMC+DEPC+WCLC+LICC-NTFR)	Euro	1,719,687	1,990,872	2,333,073	2,385,475	2,208,936
A. RAB+WACC		3,486	3,486	2,783	1,746	709
1. RAB=WACC RAB - Baza e Rregulluar e Aseteve WACC - Norma e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitallit		3,486.35	3,486.35	2,783.44	1,746.20	708.96
a. RAB= A - DEPC - AD - CG + WC + INV	Euro	98,780	98,780	78,864	49,476	20,087
A - Vlera e njohur e aktiveve të dobishëm dhe në përdorim/operim në fillim të periudhës rregullatore		150,073	150,073	207,754	214,354	214,354
DEPC - Kostot e lejuara të amortizimit (te akumuluar)		102,381	102,381	135,490	164,878	194,267
AD - Asset disposal / Retirement of assets	***	-	-	-	-	-
CG - asetet e financuara nga grantet	***	-	-	-	-	-
WC - Shpenzimet kapitale	***	-	-	-	-	-
INV - investime kur asetet është futur në shërbim dhe me koston e lejuar në p.	***	51,087	51,087	6,600	-	-
b. WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD) ES + DS = 1	%	3.53%	3.53%	3.53%	3.53%	3.53%
ES - Objektivi për raportin e kapitallit të vet në RAB	***	100%	100%	100%	100%	100%
T - Norma e takses së korporates	***	15%	15%	15%	15%	15%
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	***	3%	3%	3%	3%	3%
DS - Objektivi për raportin e bonhit në RAB	***	0%	0%	0%	0%	0%
CoD - Kosto e bonhit	***	0%	0%	0%	0%	0%
B. OPMC	Euro	1,562,897	1,806,141	2,120,388	2,168,406	2,002,871
Kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes		1,585,959	1,836,873	2,153,590	2,203,029	2,041,321
1 Qera Ofruesit të Platformës të Tregimit dhe Klerimit	***	607,525	516,876	845,000	835,710	635,700
2 Personeli, shpenzime të lidhura me Personelin	***	623,896	869,231	788,557	815,061	844,604
3 Shpenzime për materiale dhe lëndë djegëse	***	24,538	35,669	28,900	29,767	31,351
4 Shpenzime për furnitura dhe shërbime	***	138,403	196,169	243,147	283,515	281,091
5 Shpenzime postare dhe telekomunikimi	***	8,235	12,674	11,550	12,202	12,568
6 Qira zyra	***	79,696	80,074	88,000	88,000	88,000
7 Personel jashtë shoqërisë	***	44,256	48,160	48,992	47,592	47,592
8 Taksa, tatime dhe tarifa të tjera	***	30,023	37,624	41,543	42,284	45,411
9 Sigurim i Makinës	***	1,523	2,475	1,200	1,200	1,236
10 Publikime, reklama	***	5,076	9,208	26,000	16,075	21,197
11 Të tjera	***	1,015	1,980	2,000	2,060	2,122
12 Amortizimi	***	21,773	26,733	28,702	29,563	30,450
C. DEPC	Euro	21,773	26,733	28,702	29,563	30,450
Kostot e lejuara të amortizimit të vitit	***	21,773	26,733	28,702	29,563	30,450
D. WCLC	Euro	130,241	150,512	176,699	180,700	166,906
Norma e Lejuar e Kapitallit të Punës	***					
WCLC = 1/12* (OPMC+ LICC)		130,241	150,512	176,699	180,700	166,906
Koeficienti i kapitallit të punës: 1/12		0.0833333	0.0833333	0.0833333	0.0833333	0.0833333
OPMC - kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes		1,561,607	1,802,141	2,115,888	2,163,346	1,994,871
LICC - Tarifa dhe Taksat e Licencës		1,289	4,000	4,500	5,060	8,000
E. LICC	Euro	1,289	4,000	4,500	5,060	8,000
Kostot dhe Taksat e Tarifave të Licencës	***	1,289	4,000	4,500	5,060	8,000
F. NTFR	Euro	-	-	-	-	-
Të ardhurat jo tarifore	***	-	-	-	-	-
Të ardhurat Totale	Euro	1,223,967	861,436	1,558,591	1,683,712	1,992,389
Të ardhurat nga Shoqëria	***	712,006	499,676	889,563	971,302	1,156,776
Të ardhurat nga Kosova	***	511,962	361,760	669,028	712,410	835,613

Ky vlerësim parashikon përmbushjen e të gjitha detyrimeve të ALPEX SHA përgjatë viteve 2026, 2027, 2028, për kryerjen e aktivitetit normal të ALPEX SHA si edhe për të mundur mbulimin e plotë të shpenzimeve dhe investimeve, kërkohet miratimi i Listës së Tarifave për vitet 2026, 2027, 2028.

Lista e Tarifave të ALPEX SHA si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), paraqitet në tabelën më poshtë:

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Një herë	10,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës në Tregun e Ditës në Avancë	Vjetore	14,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Vjetore	8,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Një herë	7,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	3,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh në Tregun e Ditës në Avancë	Ditore	0.09 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh në Tregun e Ditës në Avancë	Ditore	0.02 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.14 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.04 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Tregtimit në Emër të Dikujt Tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtari i Bursës
Tarifa për API Përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata dixhitale për përdorues	Vjetore	50 €	Anëtari i Bursës / Anëtari i Klerimit
Tarifa Teknike	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës

❖ Mbi çdo tarifë do të aplikohet TVSH-ja.

Çdo nivel tarifë më i ulët sesa ajo e propozuar nga ALPEX, do të krijojë mungesë fondesh për mbulimin e plotë të kostove të aktivitetit të ALPEX SHA.

Shënim: Duke qenë se dy vendet operojnë në monedha të ndryshme si referencë është marrë 1 Euro = 100 Lekë.

Për sa më sipër, ALPEX SHA kërkon nga ZRRE fillimin e procedurave për miratimin e Tarifave të ALPEX SHA si Operatori i Emëruar i Energjisë Elektrike për vitin 2026, 2027, 2028.

Mbetemi në dispozicionin Tuaj për çdo informacion shtesë që mund të kërkohet nga ana Juaj në funksion të përcaktimit të tarifave.

Ju faleminderit,

Drejtore Menaxhuese e ALPEX sh.a.-Dega në Kosovë

Sokol Dishnica

Për: 